

SEKSIONI I KATËRT
ÇËSHTJA MISHGJONI k. SHQIPËRISË
(Ankimi nr.18381/05)

VENDIM
STRASBURG
7 dhjetor 2010

Ky vendim bëhet i formës së prerë në rrethanat e parashikuara në nenin 44§2 të Konventës. Ai mund të jetë objekt rishikimi redaktorial.

Në çështjen Mishgjoni k. Shqipërisë,

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt) me trup gjykues të përbërë prej:

Nicolas Bratza, kryetar

Lech Garlicki,

Ljiljana Mijović

Päivi Hirvelä

Ledi Bianku

Nebojša Vučinić

Vincent Anthony de Gaetano, gjyqtarë

dhe Lawrence Early, sekretar i seksionit,

pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 16 nëntor 2010,

merr në këtë datë vendimin e mëposhtëm:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në një ankim (nr.18381/05) kundër Republikës së Shqipërisë dërguar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) nga një nënshtetase shqiptare, znj. Mirela Mishgjoni (ankuese), më 4 maj 2005.

2. Ankuesja u përfaqësua nga z. A. Hysi, avokat që ushtron profesionin e tij në Tiranë. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u përfaqësua fillimisht nga agjentja e asaj kohe znj. S. Meneri dhe nga znj. E. Hajro pas dorëzimit të vëzhgimeve shtesë u përfaqësua.

3. Ankuesja pretendon disa shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 13 marrë në lidhje me nenin 6.1.

4. Më 1 shkurt 2008, kryetari i seksionit të katërt, të cilit i është dërguar ankimi, vendosi të njoftonte Qeverinë rreth tij. Sipas dispozitave të nenit 29 § 3 të Konventës (neni i ri 29§1) u vendos të shqyrtohej themeli i çështjes së bashku me pranueshmërinë e saj.

5. Më 9 qershor 2008, Qeveria dorëzoi komentet e saj. Ankuesja u përgjigj më 19 shtator 2009.

6. Më 7 shtator 2009, kryetari i seksionit të katërt vendosi t'i komunikonte sërish ankimin shtesë Qeverisë, në rrethanat e ofrimit të informacioneve të reja për Gjykatën. Palët iu përgjigjën me shkrim vëzhgimeve të njëra-tjetrës.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

7. Ankuesja ka lindur në Vlorë në vitin 1972 dhe banon në Vlorë.

A. Proceset administrative dhe penale kundër ankuses

8. Ankuesja është caktuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Vlorë në vitin 1996. Në dhjetor të vitit 2001 kundër saj u hap një proces disiplinor nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Mbi bazën e rezultateve të këtij procesi, prokurorisë iu kërkua të hapte një proces penal kundër ankuses. Hetimi filloi më 12 janar 2002 dhe çoi në pezullimin e ankuses nga puna po të njëjtën ditë.

9. Më 26 prill 2002, prokuroria e ndaloi hetimin penal për shkak të mungesës së provave. Gjithsesi, më 15 korrik 2002 KLD-ja e heq nga puna ankuesen për shkelje flagrante të disiplinës profesionale, ndërkohë që ajo ishte me raport mjekësor. Procesverbalet e takimeve të mëparshme të KLD-së dëshmojnë se ankuses i ishte kërkuar në disa raste të paraqitej në KLD. Ajo ka qenë me raport për një

kohë të gjatë për shkak të një neuroze depressive. KLD-ja e vijoi procesin në mungesë të saj.

B. Proceset në lidhje me heqjen e ankueses nga puna

10. Më 22 korrik 2002 ankuesja kundërshtoi vendimin e KLD-së, datë 15 korrik 2002 duke dorëzuar një ankesë në Gjykatën e Lartë, e cila është gjykata përgjegjëse për të përcaktuar çështjet e faktit dhe të ligjit. Më 18 nëntor 2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e rrëzuan ankesën.

11. Ankimi pasardhës kushtetues i ankueses për Gjykatën Kushtetuese u pranua më datë 12 nëntor 2004. Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të Konventës për shkak të procedimit në mungesë. Ajo rrëzoi të dyja vendimet (atë të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe të KLD-së) dhe e ridërgoi çështjen për shqyrtim në KLD.

12. Në përgjigje të kërkesës së ankueses për rishqyrtim të çështjes në Gjykatën e Rrethit Vlorë, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Vlorë u përgjigj më 23 dhjetor 2004 se kjo gjykatë nuk ishte organi kompetent për trajtimin e kërkesës së saj.

13. Më 28 dhjetor 2004, ankuesja i dërgon një kërkesë KLD-së për rishqyrtim çështjeje. Ajo kërkon që KLD-ja të trajtojë sërish çështjen e saj në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

14. Më 24 tetor 2008, KLD-ja vendosi të hiqte nga puna ankuesen me arsyetimin e shkeljeve flagrante që diskreditojnë seriozisht pozicionin dhe imazhin e një gjyqtari. Ankuesja e apeloj vendimin në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

15. Më 6 shkurt 2009, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e rrëzuan vendimin e KLD-së, datë 24 tetor 2008. Ato konstatuan se procedura e lidhur me masën disiplinore kishte qenë shumë e gjatë, dhe, si rezultat, masa në fjalë nuk mund të japë asnjë efekt. Si pasojë, kjo masë ishte e pavlefshme (masa disiplinore e marrë tej një afati të arsyeshëm ndaj kësaj gjyqtareje është e paefektshme dhe konsiderohet e pavlefshme ... prandaj vendimi i KLD-së duhet të shfuqizohet).

16. Në 27 shkurt 2009, ankuesja u kthye në punë si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Vlorë.

C. Procedurat në lidhje me pagimin e pagave të munguara

17. Pas ndërprerjes së procedimit penal më 26 prill 2002, ankuesja i kërkoi KLD-së dhe Ministrit të Drejtësisë t'i paguanin pagat e munguara, gjatë periudhës në të cilën ajo ishte pezulluar nga puna.

18. Më 10 prill 2003, ankuesja, duke u mbështetur në seksionet 27 dhe 38 të aktit gjyqësor, depozitoi një ankesë në Gjykatën e Rrethit Vlorë, ku kërkonte pagimin e pagave të munguara që prej 12 janarit 2002 deri më 15 korrik 2002 dhe dëmet pasuese. Më 13 shkurt 2004, Gjykata e Rrethit Vlorë (Gjykata e Rrethit) vendosi në favor të ankueses. Ajo konstatoi se përderisa proceset penale ishin ndërprerë, ankueses i duheshin paguar pagat e munguara për periudhën nga 12 janari deri më 15 korrik 2002, në përputhje me seksionin 27 të aktit gjyqësor. Në një datë të paspecifikuar, Kryetari i Gjykatës së Rrethit Vlorë e apeloj vendimin.

19. Më 5 nëntor 2004, Gjykata e Apelit Vlorë e rrëzoi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ajo u bazua në vendimin e KLD-së të datës 15 korrik 2002, sipas të cilit ankuesja ishte hequr nga puna (shih paragrafin 9 më lart). Ajo konstatoi se për aq kohë sa ishte marrë vendim për kthimin në punë të ankueses, ajo nuk mund të përfitonte marrjen e pagave të munguara.

20. Më 4 dhjetor 2004, ankuesja iu drejtua Gjykatës së Lartë. Ajo pretendoi se Gjykata e Apelit e kishte zbatuar në mënyrë të parregullt legjislacionin e brendshëm dhe nuk kishte dhënë arsye të mjaftueshme në vendimin e saj.

21. Më 21 tetor 2005, Gjykata e Lartë e rrëzoi ankesën e ankueses, duke konstatuar se ajo nuk përmbante arsye të ligjshme apeli, në përputhje me nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPP).

22. Më 26 tetor 2006, ankuesja iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke u mbështetur në të njëjtat argumente që kishte depozituar para Gjykatës së Lartë. Ajo pretendoi gjithashtu se gjykatat e brendshme nuk ishin të paanshme në shqyrtimin e çështjes së saj.

23. Më 3 korrik 2007, Gjykata Kushtetuese, me trup gjykues të përbërë prej tre gjyqtarësh, e rrëzoi çështjen si shprehimisht të pabazuar.

II. LEGJISLACIONI DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta e Shqipërisë

Pjesët përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë parashikojnë si më poshtë:

“Neni 42 § 2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

“Neni 142 § 3

Organet e shtetit janë të detyruara të zbatojnë vendimet gjyqësore.”

Neni 131

Gjykata Kushtetuese vendos për: ... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”.

B. Akti i KLD-së (ligji nr.8811, datë 17 maj 2001, ndryshuar nga ligji nr.9448, datë 5 dhjetor 2005 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”)

24. Ky ligj merret me anëtarësimin e përgjithshëm, organizimin, funksionimin dhe përgjegjësitë e KLD-së, e cila drejtohet nga Presidenti i Republikës. Ndërmjet detyrave të saj kryesore, KLD-ja vendos emërimin dhe largimin nga puna të gjyqtarëve të gjykatave të rrethit dhe gjykatave të apelit. Ligji parashikon dhe kryerjen e proceseve disiplinore kundër gjyqtarëve. Sipas ligjit, është detyrë e Ministrit të Drejtësisë të inspektojë gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit. Ministri dërgon kërkesa për fillimin e proceseve disiplinore kundër gjyqtarëve në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili shprehet me një vendim për këto kërkesa. Brenda 10 ditësh të marrjes së njoftimit për këtë vendim të KLD-së, mund të bëhet ankimim në Gjykatën e Lartë.

25. Seksioni 19 i aktit të KLD-së parashikon se Kryetari vendos për kohën dhe datën e takimeve të KLD-së, të cilat duhet të mbahen të paktën një herë në dy muaj.

C. Akti gjyqësor (ligji nr.8436, datë 28 dhjetor 1998 “Për organizimin e gjyqësorit në Republikën e Shqipërisë”)

26. Seksioni 27 i aktit të gjyqësorit parashikon se një gjyqtar pezullohet nga detyra kur kundër tij fillon një proces penal deri sa të merret një vendim përfundimtar për të. Në rastin kur gjyqtari shpallet i pafajshëm nga një vendim përfundimtar gjykatë, gjyqtari ka të drejtë të rimarrë pozicionin e tij, si dhe një kompensim të plotë për kohën kur ishte i pezulluar nga detyra.

27. Seksioni 38 parashikon se një gjyqtar ka të drejtë të marrë fletoret zyrtare, periodikët dhe buletinet gjyqësore pa pagesë.

28. Kreu V i aktit gjyqësor merret me përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve. Seksioni 40 parashikon që gjyqtarët mbajnë përgjegjësi për thyerje të disiplinës dhe kryerjeve të akteve ose sjelljeve që i diskreditojnë ata seriozisht, personalisht dhe organin e drejtësisë në përgjithësi. Seksioni 42 që parashikon heqjen nga puna si një ndër masat që mund të merret kundër një gjyqtari për shkelje të disiplinës në punë është shfuqizuar nga vendimi nr.3, datë 20 shkurt 2006 i Gjykatës Kushtetuese.

D. Kodi i Procedurës Civile

29. Nenet 324-333 trajtojnë vendimet për mosmarrëveshjet administrative. Neni 324 parashikon se një palë mund të ngrejë padi në gjykatë me synimin e kundërshtimit të refuzimit të miratimit të një akti administrativ.

30. Neni 472 parashikon si më poshtë:

“Vendimet e shpallura nga gjykata e apelit dhe ato të gjykatës së shkallës së parë, në rastet që përcaktohen nga ky Kod, mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë vetëm kur: a) nuk është respektuar ose është zbatuar keq ligji; b) ka shkelje të rënda të normave procedurale (neni 467 i këtij Kodi); c) për shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. ...”.

E. Akti i Gjykatës Kushtetuese (organizimi dhe funksionimi), (ligji nr.8577 i datës 10 shkurt 2000)

“Neni 81 – Ekzekutimi i vendimeve

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë detyruese.

2. Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese sigurohet nga Këshilli i Ministrave nëpërmjet organeve përkatëse të administratës shtetërore.

3. Gjykata Kushtetuese mund të caktojë një tjetër organ përgjegjës për ekzekutimin e vendimeve të tij dhe, sipas nevojës, dhe metodën e ekzekutimit të tij.

4. Personat që nuk zbatojnë ose parandalojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, kur veprimi i tyre nuk përbën vepër penale, janë objekt i një gjobe (...) të vënë nga Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, vendimi i të cilit është përfundimtar dhe përbën titull ekzekutiv.”.

LEGJISLACIONI

31. Ankuesja u ankua sipas nenit 6 § 1 të Konventës për moszbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, datë 12 nëntor 2004, kohëzgjatjen e proceseve administrative dhe gjyqësore në lidhje me heqjen e saj nga puna dhe proces të padrejtë në lidhje me pagimin e pagave të munguara, për periudhën gjatë së cilës ajo ishte e pezulluar nga puna.

Neni 6 § 1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Në ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile, ... çdo person ka të drejtën e një procesi të drejtë ligjor ... nga [një] ... gjykatë ...”.

32. Sipas nenit 13 të Konventës, ankuesja është ankuar për mungesë të një zgjidhjeje efektive për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, datë 12 nëntor 2004. Pjesët përkatëse të nenit 13 të Konventës parashikojnë si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”.

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

33. Qeveria u bazua në mospranueshmërinë e nenit 6.1 të Konventës në vëzhgimet e saj. Ajo parashittoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, datë 12 nëntor 2004 nuk prodhon asnjë të drejtë apo detyrim civil për ankuesen. Sipas Qeverisë, Gjykata Kushtetuese ia ktheu çështjen për rishqyrtim KLD-së pa urdhëruar kthimin në punë të ankueses.

34. Për më tepër, sipas pikëpamjes së Qeverisë, mosmarrëveshjet që lidhen me rekrutimin, karrierën dhe përfundimin e punësimit në shërbimin civil, si rregull, nuk konsiderohen si mosmarrëveshje “civile” brenda kuptimit të nenit 6.1 të Konventës. Qeveria u bazua në kriterin “funksional” siç parashikohet në çështjen *Pellegrin k. Francës* [GC], nr.28541/95, para 66-67, GJEDR 1999-VIII dhe *Pitkevich k. Rusisë* (vend.), nr. 47936/99, datë 8 shkurt 2001 në aspektin që një gjyqtar “merr pjesë drejtpërsëdrejti në ushtrimin e kompetencave që atij i njihen nga ligji publik dhe kryen detyrat që i caktohen për ruajtjen e interesave të përgjithshme të shtetit”. Qeveria i kërkoi Gjykatës të deklaronte ankesën e ankuesit si të papërputhshme *ratione materiae*.

35. Në komentet e saj shtesë Qeveria parashittoi se ankuesja nuk ishte më “viktimë”. Sipas saj, vendimi i Gjykatës së Lartë, datë 6 shkurt 2009, e njeh shprehimisht shkeljen e të drejtës për proces të drejtë ligjor për ankuesen, dhe i dha asaj *restitutio* nëpërmjet kthimit në punë të ankueses.

36. Ankuesja vijoi se proceset e gjykatave të brendshme lidhen me një të drejtë “civile” në kuadrin e vendimit të Gjykatës në çështjen *Gjyli k. Shqipërisë*, nr. 32907/07, § 37, datë 29 shtator 2009 dhe *Vilho Eskelinen dhe të Tjerë k. Finlandës* [GC], nr.63235/00, § 62, GJEDNJ 2007-IV, § 62, datë 8 gusht 2006. Ajo u shpreh se ka përdorur të gjitha mjetet e brendshme juridike në lidhje me ankimin e saj.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Objekti i çështjes

37. Gjykata thekson se Gjykata është organi i duhur për të bërë tipizimin e çështjes në përputhje

me ligjin, mbi bazën e fakteve të çështjes. Ajo nuk ndihet e detyruar të pranojë përshtetimin e dhënë nga ankuesja ose nga Qeveria (*shih çështjen Mullahi dhe të Tjerë k. Shqipërisë*, nr. 9074/07, § 73, datë 23 mars 2010).

38. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Kushtetuese, datë 12 nëntor 2004, e dërgoi çështjen për rishqyrtim në KLD, pa vendosur përfundimisht për themelin e çështjes. Po ashtu, Gjykata Kushtetuese nuk mori ndonjë vendim përfundimtar në favor të ankueses (bëni krahasime dhe kontraste *me çështjen Gjyli*, të përmendur më lart). Si rezultat, Gjykata është e mendimit se dy ankesat e para të ankueses duhet të shqyrtohen nga pikëpamja e përputhshmërisë me kërkesën për “kohë të arsyeshme” të parashikuar në nenin 6 të Konventës.

39. Më tej, Gjykata është e mendimit se kohëzgjatja e secilit grup procesesh, çfarë do të thotë që si proceset për heqjen nga puna dhe proceset e pagave të papaguara, duhet të shqyrtohen veçmas, pasi proceset që kanë të bëjnë me pagesat e munguara përfshijnë palë të ndryshme dhe argumente të ndryshme ligjore në lidhje me një temë/çështje të ndryshme.

b) Në lidhje me përputhshmërinë e pretenduar *ratione materiae*

40. Në vendimin *Vilho Eskelinen dhe të Tjerë*, të cituar më lart, Dhoma e Madhe e Gjykatës vendosi të rishqyrtonte kriterin e përcaktuar në vendimin për çështjen Pellegrin, përmendur më lart, për të përcaktuar zbatueshmërinë e nenit 6 për mosmarrëveshjet që lidhen me marrjen në punë dhe heqjen nga puna të nëpunësve civilë. Dhoma e Lartë vendosi në çështjen *Vilho Eskelinen dhe të Tjerë* që neni 6 § 1 sipas parashikimit të tij “civil” duhet të jetë i zbatueshëm për të gjitha mosmarrëveshjet që përfshijnë nëpunësit civilë, me përjashtim të rasteve kur legjislacioni i brendshëm e përjashton shprehimisht të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës për postin ose kategorinë e stafit në fjalë, dhe kur ky përjashtim është i justifikuar me arsye objektive që janë në interes të shtetit. Në parim, nuk mund të ketë justifikim për përjashtimin nga garancitë e nenit 6 të mosmarrëveshjeve të zakonshme të lidhura me punën, të tilla si mosmarrëveshje që lidhen me pagat, dietat ose të drejtat e tjera të ngjashme, mbi bazën e natyrës së veçantë të marrëdhënies ndërmjet një nëpunësi të caktuar civil dhe shtetit në fjalë (*shih Vilho Eskelinen dhe të Tjerë*, cituar më lart, para 62).

41. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se pretendimi civil i ankueses u shqyrtua dhe u pranua nga Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese. Ankuesja nuk është e përjashtuar nga legjislacioni i brendshëm “nga e drejta për t’iu drejtuar gjykatës” brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Bazuar në testin e zhvilluar në çështjen *Vilho Eskelinen dhe të Tjerë*, përmendur më lart, Gjykata arrin në përfundimin se neni 6 është i zbatueshëm për proceset e brendshme rreth kësaj çështjeje (*shih edhe Olijic k. Kroacisë*, nr. 22330/05, §§ 31-43, datë 5 shkurt 2009, ku Gjykata shprehet se neni 6 i Konventës është i zbatueshëm për proceset disiplinore kundër një gjyqtari). Si rezultat, Gjykata e rrëzon këtë kundërshtim.

c) Në lidhje me pretendimin e mungesës së statusit “të viktimës” për ankuesen

42. Gjykata thekson se një vendim ose masë në favor të ankuesit, në parim, nuk është i mjaftueshëm e për t’i mohuar individit statusin e tij/saj të “viktimës”, me përjashtim të rasteve kur organet kombëtare kanë njohur ose shprehimisht ose në thelb shkeljen e Kushtetutës dhe kanë ofruar shpërblim për këtë shkelje (*shih Ammur k. Francës*, datë 25 qershor 1996, § 36, raportet e vendimeve gjyqësore 1996-III dhe *Dalban k. Rumanisë* [GC], nr.28114/95, § 44, GJEDNJ 1999-VI).

43. Në këtë çështje, Gjykata është e mendimit se ndërsa është zbatuar vendimi përkatës dhe Gjykata e Lartë e nje shkeljen e të drejtës së ankueses për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, vendimi i Gjykatës, datë 6 shkurt 2009, nuk qe i suksesshëm për sa i përket përcaktimit të një dëmshpërblimi, për periudhën gjatë së cilës ndodhi shkelja. Kthimi në punë i ankueses nuk e ndreq situatën *a priori*. Në këto rrethana, ankuesja mund të vazhdojë të pretendojë se është “viktimë” e shkeljes së të drejtave të saj që i njihen nga Konventa, si rezultat i vonësave në respektimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Si rezultat, Gjykata e rrëzon këtë kundërshtim.

d) Në lidhje me zgjatjen e pretenduar të proceseve lidhur me pagat e munguara

44. Gjykata thekson se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së proceseve duhet të trajtohet në kuadrin e rrethanave të çështjes dhe duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme: kompleksitetin e çështjes, sjelljen e ankueses dhe të organeve përkatëse dhe çfarë rrezikonte ankuesja në mosmarrëveshje (*shih, për shembull, Gjonbocari dhe të Tjerë k. Shqipërisë*, nr.10508/02, § 61, datë 23 tetor 2007).

45. Gjykata është e mendimit se proceset që lidhen me pagat e munguara, që mbulojnë periudhën që prej datës 10 prill 2003 e deri më 3 korrik 2007, kanë një kohëzgjatje prej pak më shumë se katër vjetësh për katër nivele gjykimi. Duke pasur parasysh numrin e niveleve të gjykimit, Gjykata nuk është e mendimit se kohëzgjatja e proceseve në lidhje me pagat e munguara është e paarsyeshme, duke marrë parasysh dhe çfarë rrezikonte ankuesi (shih për shembull, çështjen *Gjonbocari dhe të Tjerë*, përmendur më lart, § 62).

46. Rezulton se kjo ankesë është shprehimisht e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

e) Në lidhje me proceset e parregullta ligjore lidhur me pagat e munguara

47. Ankuesja ankohet se proceset në lidhje me pagimin e pagave të munguara janë të parregullta për aq kohë sa vendimi i Gjykatës së Lartë datë 21 tetor 2005 dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese datë 3 korrik 2007 nuk janë plotësisht të arsyetuara.

48. Qeveria parashtroi se proceset gjyqësore kanë qenë të rregullta. Më tej Qeveria vijon se gjykatat e brendshme kanë respektuar barazinë e palëve dhe kanë trajtuar argumentet e palëve duke ofruar arsye të mjaftueshme. Sipas Qeverisë, ankimi i ankueses lidhet kryesisht me interpretimin e të drejtës së brendshme, gjë që është kryesisht detyrë e gjykatave kombëtare. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit ka vendosur kundër ankueses në kuadrin e vendimit të Gjykatës së Lartë, datë 18 nëntor 2002, e cila ka pranuar heqjen e ankueses nga puna. Si pasojë, ankuesja nuk ka të drejtë të përfitojë pagat e munguara.

49. Gjykata thekson se nuk i takon asaj të zëvendësojë vlerësimin e fakteve të gjykatave të brendshme me vlerësimin e saj dhe, si rregull i përgjithshëm, u takon këtyre gjykatave të vlerësojnë provat që u janë parashtruar dhe të interpretojnë të drejtën e brendshme (shih *Jakupi k. Shqipërisë*, nr.11186/03, datë 1 dhjetor 2009). Detyra e Gjykatës është që të sigurohet që proceset gjyqësore kanë qenë në tërësi të drejta ose jo.

50. Nga dosja e çështjes rezulton se ankuesja ka pasur mundësinë e të drejtuarit në procese të ndryshme. Ajo e ka parashtruar çështjen në gjykatat e brendshme, të cilat kanë vendosur për themelin e çështjes pas shqyrtimit dhe vlerësimit të të gjitha provave para tyre. Gjykata nuk është në gjendje të identifikojë ndonjë arbitraritet në proceset gjyqësore të gjykatave të brendshme.

51. Arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj, datë 1 tetor 2005, dëshmojnë qartazi se ankuesja nuk ka ngritur një pikë të parashikuar në dispozitat e legjislacionit të brendshëm, e cila është kërkesë për pranueshmëri për dhënien e lejes për apelim. Gjykata vëren se kur Gjykata e Lartë kundërshton pranimin e një çështjeje mbi arsyetimin se nuk janë parashtruar arsyet ligjore për ngritjen e kësaj çështjeje, vetëm një arsyetim shumë i kufizuar mund të plotësojë kërkesat e nenit 6 të Konventës (shih *mutatis mutandis*, *Marini e të tjerë k. Shqipërisë*, nr.3738/02, § 106, GJEDNJ 2007-XIV (ekstrakte). Më tej, përderisa apelimi kushtetues i ankueses përmbante të njëjtën bazë apelimi si çështja që i është dërguar Gjykatës Kushtetuese, i njëjti arsyetim mund të thuhet se mund të përdoret në lidhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, datë 3 korrik 2007 (shih *çështjen Jakupi*, përmendur më lart).

52. Për arsyet e mësipërme, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë është shprehimisht e pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3, dhe, si rezultat, është e papranueshme në përputhje me nenin 35 § 4 të Konventës.

f) Në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve që kanë të bëjnë me heqjen e ankueses nga puna

53. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar brenda kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton më tej, se kjo ankesë nuk është e papranueshme për arsye të tjera. Si rezultat, kjo ankesë deklarohet e pranueshme.

B. Themeli i çështjes

1. Parashtrimet e palëve

54. Qeveria deklaroi se përbërja e KLD-së në vitin 2005 ka pësuar ndryshime drastike për shkak të zëvendësimit të disa prej anëtarëve të saj. KLD-ja me anëtarë të rinj ka qenë e angazhuar shumë në marrjen e vendimeve me synimin e zgjidhjes së problemeve të gjyqësorit, duke përcaktuar çështjet parësore, të tilla si emërimi i kryetarëve të gjykatave të brendshme, hetime disiplinore dhe miratimin e akteve ligjore të lidhura me performancën e gjyqësorit.

55. Ankuesja pretendoi se vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ishte zbatuar, megjithëse KLD-ja

ishite mbledhur dhe kishte trajtuar çështje disiplinore të lidhura me gjyqtarë të tjerë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

56. Gjykata vëren se proceset e heqjes nga puna kanë filluar të paktën më 22 korrik 2002 dhe kanë përfunduar më 6 shkurt 2009. Gjykata është e mendimit se periudha që duhet të merret parasysh duhet të mbulojë gjithë kohështrirjen e proceseve për heqjen nga puna. Pra, këto procese kanë zgjatur më shumë se tetë vite për tre nivele juridiksioni.

57. Gjykata i referohet paragrafit 44 për parimet e përgjithshme nën nenin 6.1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore.

58. Gjykata është e mendimit se proceset e heqjes nga puna nuk kanë paraqitur ndonjë element kompleksiteti. Ankuesja u kërkoi organeve të respektonin vendimin e Gjykatës Kushtetuese me anë të letres së saj, datë 28 dhjetor 2004. Nuk mund të thuhet se ajo ka qëndruar pasive ose nuk ia ka dalë të shfaqë gatishmërinë e nevojshme. Po ashtu, nga shqyrtimi i dosjes së saj nuk rezulton se ajo ka pasur ndonjë vonesë në reagim. Në lidhje me sjelljen e organeve, Gjykata vëren se nga data 12 nëntor 2004 deri më 24 tetor 2008 nuk ka pasur asnjë vendim në lidhje me themelin e çështjes së ankueses që ka pasuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Çështja e ankueses u trajtua sërish nga KLD-ja vetëm në vitin 2008, duke respektuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese, datë 12 nëntor 2004. Del se, siç është parashtruar nga Qeveria, gjatë asaj kohe KLD-ja ka vendosur për masa të tjera disiplinore të ngjashme me atë të ankueses. Gjykata nuk gjen ndonjë arsye të qenësishme për mungesën e rishqyrtimit të çështjes së ankueses deri në atë kohë.

59. Gjykata nuk mund të pranojë argumentet e Qeverisë se ndryshimet në përbërjen e KLD-së në vitin 2005 dhe ripërcaktimi i përparësive të saj mund të justifikojnë vonesën thuajse katërvjeçare në rishqyrtimin e çështjes së ankueses. Gjykata thekson se një punonjës që mendon se është pezulluar ose hequr nga puna gabimisht nga punëdhënësi i tij/saj ka interes të madh vetjak në sigurimin e një vendimi gjyqësor për ligjshmërinë e këtij akti menjëherë. Për shkak të natyrës së tyre, mosmarrëveshjet e lidhura me punësimin kërkojnë vendim të shpejtë, duke marrë parasysh se çfarë vihet në rrezik për personin në fjalë, i cili nëpërmjet heqjes nga puna humb mjetet e të jetuarit (shih *Frydlender k. Francës* [GC], nr. 30979/96, § 45, GJEDNJ, 2000-VII, përmendur më lart, §45). Më tej, Gjykata thekson se u takon shteteve kontraktuese të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që organet kompetente të mund të plotësojnë kërkesat e nenit 6 të Konventës, duke përfshirë dhe detyrimin për trajtimin e çështjeve brenda një kohe të arsyeshme (shih *Makarova k. Rusisë*, nr.23554/03, para 42, datë 1 tetor 2009).

60. Gjykata mendon se një vonesë e përgjithshme prej thuajse katër vitesh nga KLD-ja për të shqyrtuar sërish çështjen e ankueses nuk e plotëson kërkesën e “kohës së arsyeshme” të Konventës. Si rezultat, është shkelur nenin 6.1 i Konventës në lidhje me proceset e heqjes nga puna.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 NË LIDHJE ME NENIN 6.1 TË KONVENTËS

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

61. Ankuesja parashtrroi se nuk ka pasur mjete të disponueshme dhe efektive në lidhje me ankimin e saj në bazë të nenit 6.1 të Konventës për sa i përket kohëzgjatjes së proceseve për heqjen e saj nga puna.

62. Qeveria parashtrroi se neni 13 nuk është i pranueshëm në kuadrin e argumentimit të tij për mospranueshmëri të nenit 6.

2. Vlerësimi i Gjykatës

63. Gjykata vëren se në mënyrë që neni 13 të jetë i zbatueshëm, ankuesja duhet të ketë “pretendim të argumentuar” që dëshmon se ajo ka qenë objekt i shkeljes së të drejtave të parashikuara në Konventë (shih *Boyle dhe Rice k. Mbretërisë së Bashkuar*, datë 27 prill 1988, § 55, seritë A, nr.131).

64. Në çështjen në fjalë, është e qartë se ankuesja ka pretendim të argumentuar në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore brenda kuptimit të nenit 6 të Konventës. Gjykata konstaton se neni 13 është i zbatueshëm dhe rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

65. Gjykata është e mendimit se kjo ankesë nuk është shprehimisht e pabazuar brenda kuptimit të

nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, Gjykata konstaton se ajo nuk është e papranueshme për asnjë arsye tjetër. Si rezultat, kjo pikë duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

66. Qeveria insistoi se ankuesja mund të kishte ngritur padi për mosveprim kundër KLD-së në përputhje me nenin 324 të Kodit të Procedurës Civile. Qeveria vijon se ankuesja mund t'i kishte kërkuar Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese vendosjen e një gjobe në përputhje me seksionin 81 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

67. Ankuesja u përgjigj se ekzekutimi i vendimit të Gjykatës Kushtetuese i takon Këshillit të Ministrave. Në çdo rast, KLD-ja e kishte neglizhuar rishqyrtimin e çështjes së saj, megjithëse KLD-ja kishte trajtuar procese të tjera disiplinore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

68. Neni 13 i Konventës garanton disponueshmërinë në nivel kombëtar të një mjeti për zbatimin e thelbit të të drejtave dhe lirive të Konventës në çfarëdolloj forme që mund të paraqiten në rendin e brendshëm juridik (shih *Kudla k. Polonisë* [GC], nr. 30210/96, § 157, GJEDNJ 2000-XI).

69. Qëllimi i detyrimeve të palëve kontraktuese sipas nenit 13 varion në varësi të natyrës së ankesës së ankuesit. Gjithsesi, mjetet që kërkohen nga neni 13 duhet të jenë “efektive” në praktikë dhe në ligj (shih, për shembull, *Ilhan k. Turqisë* [GC], nr. 22277/93, § 97 GJEDNJ 2000-VII) në kuptimin ose të parandalimit të shkeljeve të pretenduara ose në parandalimin e vijimit të tyre, ose të ofrimit të dëmshpërblimit për shkeljet që kanë ndodhur (shih *Kudla, përmendur më lart*, § 158).

70. Është e vërtetë që, siç u theksua dhe nga Qeveria, ankuesja mund të kishte kundërshtuar mosveprimin e KLD-së në përputhje me nenin 324 (b) të KPC-së, ose mund të kishte depozituar një kërkesë në përputhje me seksionin 81 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese. Gjithsesi, Gjykata nuk është e bindur se ndonjëri nga këto mjete do të ishte efektiv në praktikë kur bëhet fjalë për ankesat për kohëzgjatjen e proceseve. Qeveria nuk ka ofruar asnjë çështje nga jurisprudenca e gjykatave kombëtare që dëshmon se është vendosur në favor të ankuesit në situata të ngjashme.

71. Për më tepër, Gjykata ka konstatuar shkelje të ngjashme të nenit 13 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve për Shqipërinë (shih, për shembull, *Gjonbocari dhe të tjerë k. Shqipërisë*, nr.3738/02, § 147-158, GJENJ 2007-XIV (ekstrakte)).

72. Gjykata konstaton se ankuesja nuk kishte mjete as për të parandaluar vazhdimin e shkeljes së të drejtave të saj, parashikuar në nenin 6.1 të Konventës, dhe as për të marrë kompensim. Si rezultat, Gjykata konstaton se nuk ka pasur mjete efektive për ankimin e ankueses në lidhje me tejzgjatjen e proceseve të heqjes nga puna. Gjykata do t'i kthehet kësaj çështje.

73. Si rezultat, ka pasur shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6.1 të Konventës.

III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

74. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

75. Ankuesja pretendon 80,000 euro për dëme materiale, të cilat përbëhen nga humbja e pagës dhe përfitimeve në periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2009. Ankuesja nuk paraqiti një detajim të përlogaritjes së pagës dhe përfitimeve të tjera. Më tej, ajo kërkon 20,000 euro për dëme jomateriale.

76. Qeveria parashtrroi se konstatimi i shkeljes përbën në vetvete shpërblim të drejtë. Ajo vijon se ankuesja nuk ka parashtruar dokumente në mbështetje të pretendimit të saj për dëm material dhe dëm jomaterial. Në pikëpamjen e Qeverisë ankuesja nuk ka vuajtur nga mungesa e të ardhurave pasi ajo ka punuar si praktikuese ligjore që prej vitit 2003.

77. Në çështjen në fjalë Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 6.1 të Konventës në lidhje me

kohëzgjatjen e proceseve të heqjes nga puna dhe të nenit 13 në lidhje me nenin 6.1 në lidhje me mungesën e mjeteve efektive për kohëzgjatjen e këtyre proceseve. Gjykata nuk shquan ndonjë lidhje shkak-pasojë ndërmjet shkeljeve të konstatuara dhe dëmit material të pretenduar.

78. Gjithsesi, Gjykata është e mendimit se ankueses i është shkaktuar një masë e caktuar stresi dhe nervozizmi si rezultat i kohëzgjatjes të proceseve gjyqësore që ka cenuar mënyrën e saj të jetesës, dhe i akordon asaj 2,000 euro si dëm jomaterial.

B. Kostot dhe shpenzimet

79. Ankuesja kërkoi 6,000 euro për kostot dhe shpenzimet e proceseve në gjykatat e brendshme dhe në këtë Gjykatë. Ajo parashtroi një ndarje të detajuar të shpenzimeve për të mbështetur pretendimin e saj.

80. Qeveria e kundërshtoi shumën duke u shprehur se ankuesja nuk kishte depozituar fatura tatimore të njohura zyrtarisht.

81. Gjykata thekson se vetëm kostot dhe shpenzimet ligjore që rezultojnë të jenë kryer e të kenë qenë të domosdoshme (në rastin e proceseve në gjykatat e brendshme, gjatë kërimit të dëmshpërblimit për shkeljen e konstatuar të Konventës ose të parandalimit të ndodhjes së shkeljes) dhe të cilat janë të arsyeshme në sasi janë të rimbursueshme në kuptimin e nenit 41 të Konventës (shih, për shembull, *Nikolova k. Bullgarisë* [GC], nr.31195/96, § 79, GJEDNJ 1999-II; *Smith dhe Grady k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr.33985/96 dhe 33986/96, § 28, GJEDNJ 1999-VI; dhe *Roche k. Mbretërisë të Bashkuar* [GC], nr.32555/96, § 182, GJEDNJ 2005-X).

82. Gjykata është e mendimit se tarifat e avokatit të ankueses për proceset në gjykatat e brendshme nuk përbëjnë shpenzime të kryera për kërkimin e dëmshpërblimit për shkeljet e Konventës të konstatuara për çështjen në fjalë. Gjithsesi, duke bërë vlerësimin e saj mbi një bazë të barabartë, Gjykata i akordon ankueses 1,000 euro në lidhje me proceset në Strasburg.

C. Interesi i munguar

83. Gjykata e mendon të arsyeshme se interesi i munguar duhet të bazohet në nivelin marginal të huas së Bankës Qendrore Europiane, mbi të cilën duhet të shtohen tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Deklaron* ankimin sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me procesin e parregullt ligjor dhe zgjatjen e proceseve gjyqësore në lidhje me pagat e munguara të papranueshme dhe pjesën tjetër të ankimit të pranueshme.

2. *Vendos* se ka shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me kohëzgjatjen e proceseve për heqjen nga puna.

3. *Vendos* se ka shkelje të nenit 13 në lidhje me nenin 6 § 1 të Konventës në lidhje me mungesën e mjeteve efektive që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e proceseve të heqjes nga puna.

4. *Vendos*:

a) se shteti i paditur duhet t'i paguajë ankueses, brenda tre muajsh nga data në të cilën vendimi bëhet përfundimtar sipas parashikimit të nenit 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të konvertuara në monedhën e shtetit të paditur, sipas kursit të këmbimit në datën e pagimit:

i) 2,000 (dy mijë euro), plus çdo tatim që mund të vendoset në lidhje me dëmin jomaterial;

ii) 1,000 (një mijë euro), plus çdo tatim që mund t'i ngarkohet ankueses në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) që, prej skadimit të tremujorit të përmendur më lart deri në kryerjen e pagesës për ankuesen, mbi shumën e përmendur më lart paguhen interesa të thjeshta, sipas shkallës së interesit të barabartë me nivelin marginal të huas së Bankës Qendrore Europiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre për qind.

5. *Drëzon pjesën tjetër të pretendimit të ankueses për dëmshpërblim të drejtë.*

E bërë në anglisht dhe e njoftuar me shkrim me datën 7 dhjetor 2010, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

Lawrence Early
Sekretar

Nicolas Bratza
Kryetar